



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:324943

Datë: 19.02.2025

Numri i dokumentit: 06867956

2024:329989

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtare ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit H.A. nga fsh., për shkak të veprave penale Vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), duke vepruar sipas Aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1843/24 të dt. 18.11.2024 dhe PP/II.1641/24 të dt.18.11.2024, ka mbajtur shqyrtimin fillestar publik më datë 10.02.2025, në prani të prokurorit të shtetit Albert Zejnullahu, përfaqësuesit të palës së dëmtuar APK-së Ferizaj-Lumni Salihu, dhe të pandehurit dhe po të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datën 19.02.2025, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri H.A., nga i ati A., e ëma Sh., e gjinis B., i lindur në Ferizaj, me vendbanim në rrugën “...” në fshatin K Ferizaj, i pa punë, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar edhe më parë për veprë penale, ndaj tij nuk udhëhiqen procedura tjera penale.

ËSHTË FAJTOR

Sepse

1. Me datën 15.10.2024, rreth orës 10:55, saktësisht në vendin e quajtur “ Ngastra/16”, në Rajonin Ekonomiko-PyJOR Jezerci-I, i pandehuri me qëllim të vjedhjes, ka prerë me sharrë motorike 6 copë dru të llojit ahu, boniteti III, me diametër 23-41cm dhe me vëllim të përgjithshëm prej 3.74 m³, ashtu që të njëjtat i ka bartur me traktor, me ç’rast të dëmtuarës Agjencia Pyjore e Kosovës i ka shkaktuar dëm material në vlerë rreth 525.24€.

Me çka ka kryer veprën penale Vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së).

2.Me datën 04.09.2024, rreth orës 11:00, saktësisht në vendin e quajtur “ Ngastra/15”, në Rajonin Ekonomiko-PyJOR Jezerci I, i pandehuri me qëllim të vjedhjes, ka prerë me sharrë motorike 3 copë dru të llojit ahu, boniteti III, me diametër 40cm dhe me vëllim të përgjithshëm prej 3.06 m³, ashtu që të njëjtat i ka bartur me traktor ..., me ç’rast të dëmtuarës Agjencia Pyjore e Kosovës i ka shkaktuar dëm material në vlerë rreth 413.10€,-

Me çka ka kryer veprën penale Vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së).

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 ,70, dhe nenit 349 par.1 të KPRK-së si dhe nenit 365, 452, 462 të KPPK-së, të pandehurit i:

CAKTON DËNIM

Për pikën 1. të dispozitivit, dënim me gjobë, në shumë prej 200 € /dyqind euro/.

Për pikën 2. të dispozitivit, dënim me gjobë, në shumë prej 200 € /dyqind euro/.

Gjykata konform nenit 76 të KPRK-së, të akuzuarin e:

GJYKON ME DËNIM UNIK

Me gjobë

Në shumë prej 400 € /katërqind euro/, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shëndrrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumë prej nga 20 Euro (njëzet euro), si dhe në emër të kompensimit të Viktimave të Krimit shumë prej nga 20 € (njëzetë euro), në kuptim të nenit 36 par. 3 nen par. 3.1, Nr. 08/L-109, të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit, brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Po ashtu obligohet i pandehuri që Agjencionit Pyjor të Kosovës- Drejtorisë në Ferizaj, ti kompensojë dëmin e shkaktuar, në shumë prej 938.34 €, në afatin e njëjtë sikurse dënimin.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzat, PP/II.nr. 1843/24 të dt. 18.11.2024 dhe PP/II.1641/24 të dt.18.11.2024, ka akuzuar të pandehurin për shkak të veprave penale Vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjeve penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështjet janë në juridiksionin e saj dhe gjykimi i këtyre çështjeve penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi veprat penale që janë proceduar për të akuzuarin gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku janë kryer ose tentohet të kryhen veprat penale.

Gjykata duke vepruar në çështjet penale caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.03.02.2025, në të cilin shqyrtim kanë marrë pjesë prokurori i shtetit, përfaqësuesi i palës së dëmtuar dhe i pandehuri.

Gjykata pasi ka vërejtur se ndaj të pandehuri janë paraqitur dy aktakuza nga prokuroria e shtetit dhe veprat penale në to janë të natyrës së njëjtë, objekti i njëjtë, dashja e njëjtë dhe janë kryer në intervale kohore të përafërta, për shkaqe të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës, pas marrjes së mendimit dhe pëlqimit të palëve lidhur me bashkim të procedurave penale, në kuptim të nenit 35 të KPPK-së, vendosi për bashkimin e lëndëve penale me nr.2024:329989 me numër të aktakuzës PP/II.nr.1843/24 të dt. 18.11.2024 dhe lëndës 2024:329996 me aktakuzën numër dhe PP/II.nr.1641/24 e dt.18.11.2024, kundër të pandehurit për shkak të veprave penale Vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, dhe në të ardhmen procedura penale për këto dy lëndë do të udhëhiqet me numrin më të vogël të lëndës 2024:329989.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të pandehurin për të drejtat e tij në kuptim të nenin 241 par.1 të KPPRK-së. Pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzave nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzat, në pajtim me neni 241 paragrafi 4 të KPPRK-së, i ka afruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprat penale për të cilat është i akuzuar.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar publik ka deklaruar e pranoj fajësinë për veprat penale që më ngarkojnë aktakuzat sipas të gjitha pikave të tyre, për veprat penale Vjedhje pylli nga neni 349 par.1 të KPRK-së, jam i njoftuar me pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e bëj në mënyrë vullnetare, më vjen keq që kam vepruar kështu, por për shkak të kushteve të vështira ekonomike jam detyruar të prej dru pa leje, drunjte i kam shfrytëzuar për nevojat e mija familjare, dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsëris këso lloj vepra penale apo të ngjashme, kërkoj nga gjykata që mundësisht të më shqiptoj ndonjë dënim sa më të butë që është e mundur

Prokurori shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri, këtë e bëri vullnetarisht pa presion dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimit, kjo ka mbështetje edhe në provat materiale që gjenden në shkresa të lëndës, kërkoj nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj konform ligjit duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat si rrethana rënduese të merr përgjegjësin penale të tij, dashjen, dëmin e shkaktuar si dhe të kaluarën dhe karakteristikat e tij personale duke e ditur se i njëjti

është edhe recedivist, ndërsa si rrethanë lehtësuese të merr pranimin e fajësisë, pendimin dhe premtimin e tij ashtu që me sanksionin e shqiptuar të arrihet qëllimi i dënimit.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar APK, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se qëndrojmë pranë asaj që deklaroi prokurori i shtetit dhe paraqesim kërkesë pasurore juridike lidhur me dëmin që na është shkaktuar sipas dispozitiveve të aktakuzave.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuzat nuk përmbajnë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rasteve konkrete dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit dhe atë: për veprën penale në pikën një të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Deklarata e të pandehurit H.A. e dhënë para Prokurorit të Shtetit me dt. 13.11.2024, Fletëparaqitja e rojës së pyllit me nr. ditari 09/24 dhe NP.101/24 e dt.18.10.2024, Fotografitë nga vendi i ngjarjes, ndërsa për veprën penale në pikën e dytë të dispozitivit, Deklarata e të pandehurit H.A. e dhënë para Prokurorit të Shtetit me dt. 13.11.2024; Fletëparaqitja e rojës së pyllit me nr. ditari dhe, si dhe shkresat e tjera të cilat gjenden në lëndët.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë për të gjitha veprat penale veç e veç dhe pranimi i fajësisë është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 242 paragrafit 6 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit për të gjitha rastet ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprave penale Vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, e të cilat janë të përshkruara më hollësisht si në dispozitive të

këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së veprave penale, andaj dhe për këtë të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim unik siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i pandehuri në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë, është penduar për kryerje të veprave penale, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërisë kesi lloj veprave penale apo të ngjashme, gjendjen e dobët ekonomike të tij, ndërsa në rastin konkret si rrethana rënduese gjeti se i pandehuri edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra penale vjedhje pylli me aktgjykimet të plotfuqishme dhe atë P.292/2019 i dt.03.09.2020, me dënime gjobë, P.2022:065937 i dt. 25.09.2023 me dënim me kusht, dhe 2024:094449 të datës 24.07.2024, me dënim me gjobë. Dhe përveç kësaj që u tha më lartë gjykata vlerësoi edhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes së veprave penale, rrezikshmërisë dhe të autorit të tyre, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi kërkesën pasurore-juridike, është marruar në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par 3 pika 3.1, Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal,
2024:329989, e dt.19.02.2025

Zyrtare ligjore:

Kimete Bytyqi

Gjyqtari i vetëm gjykues:

Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.